



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dispozitave të Statutit të Komunës së Gjakovës, dhe vendimit të Kuvendit Komunal të Gjakovës 01-011/01-21901 të datës 28.09.2022, Komisioni për ndryshimin e Stëmës së Komunës së Gjakovës, me datë 28.02.2023 shpall:

K O N K U R S
për dizajnimin e Stëmës së Komunës së Gjakovës

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë personat fizik dhe juridik, rezident dhe jo rezident të Republikës së Kosovës, e të cilët nuk janë anëtarë të komisionit për ndryshimin e stëmës apo komisionit profesional për përzgjedhjen e punimeve më të mira, apo që këto komisione i kanë angazhuar në punën e tyre.

Propozimi për zgjidhje ideore të Stëmës së Komunës së Gjakovës, duhet të jetë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03-L-040 dhe Statutin e Komunës së Gjakovës, të i'u përgjigjet karakteristikave historike, kulturore, natyrore dhe karakteristikave tjera të Komunës së Gjakovës.

Propozimi nuk mund të ketë formë të njejtë apo të modifikuar me simbolet shtetërore dhe nacionale të Kosovës apo shteteve tjera, me logot e partive politike, shoqërive tregtare, institucioneve, subjekteve tjera juridike dhe organizatave.

Kriteret e përgjithshme për hartimin e zgjidhjes ideore të Stëmës:

- Numri, paraqitja dhe përmbajtja e fushave në modelin e propozuar të Stëmës duhet të jetë e përshtatshme për praktikën heraldike;
- Stema duhet të punohet në dy variante themelore (e ashtuquajtura stema e vogël) dhe të zgjeruar, respektivisht zyrtare (e ashtuquajtur stema e mesme);
- Renditja dhe përmbajtja e fushave në mburojë duhet ti plotësojnë kushtet e praktikës heraldike dhe përmbajtja e tyre duhet të përputhet me kërkesat nga pika e konkursit;
- Stema e zgjeruar – zyrtare duhet të ketë mbishkrimin me tekstin Gjakova;
- Trajta dhe forma e stëmës duhet të mundësoj teknikën e printimit në disa ngjyra dhe që stema, si simbol mund të përdoret për punimin e pllakave, diplomave, shenjave, mirënjohjeve publike, suvenireve dhe të ngjashme.

Kushtet e veçanta:

- a) Vizatimet që paraqesin propozimin për Stemë duhet të bëhen me ngjyra dhe të paraqiten në fleta të veçanta të formatit A4;
- b) Secila nga fletët që përmban propozimet duhet të jetë e shënuar individualisht me një kod dhe një numër;
- c) Në fletë të formatit A4 duhet të dorëzohet varianti “bardh – zi” i të njejtës;
- d) Në fleta të veçanta të formatit A4 duhet të dorëzohen shembuj të detajuar me aplikimin e stemës së propozuar në memorandume, zarfe postare dhe kartëvizita;
- e) Teknika e bërjes së propozimit mund të jetë edhe me dorë por me ngjyrë (teknikat: dush, temper, bojra uji, ose një kombinim i këtyre teknikave);
- f) Përveç dorëzimit të vizatimeve në letër, propozimi paraqitet edhe në formë elektronike në CD në mënyrë që kodi dhe numri i vizatimeve të shënohen në vetë CD-në dhe në paketimin e saj;
- g) Me vizatime është e domosdoshme të bashkëngjitet një përshkrim tekstual se çka përfaqëson secila ngjyrë apo secili detaj i Stemës.

Afati i dorëzimit të propozimeve, zgjedhja e tyre dhe shpërblimet:

- a) Punimet dorëzohen në pako (zarf) me KOD, më së largu deri në ora 16:00 të ditës së fundit të konkursit në adresën: **Komuna e Gjakovës, rr. Nënë Tereza 50000 Gjakovë**, me mbishkrimin: **Konkursi për Dizajnimin e Stemës së Komunës së Gjakovës**;
- b) Me punim, në zarf të veçantë të mbyllur është e nevojshme të dorëzohen edhe të dhënat personale të pjesëmarrësve (emri dhe mbiemri, adresa e banimit dhe numri i telefonit) si dhe deklaratën e nënshkruar të autorit që nëse ai shpërblehet, e drejta e autorit transferohet automatikisht tek komuna e Gjakovës dhe se propozimi i ofruar është krijim personal i autorit;
- c) Konkursi zgjatë 30 ditë nga dita e publikimit deri me datë 29.03.2023

Shpërblimet e propozuara janë si vijon:

- a) Shpërblimi i parë 2000€
- b) Shpërblimi i dytë 1000€
- c) Shpërblimi i tretë 500€

Kushtet e konkursit

- a) Çdo pjesëmarrës i konkursit mund të marrë pjesë me më së shumti tri punime. Çdo punim duhet të iu dorëzohet komisionit si dërgesë (punim) i veçantë dhe me kod të veçantë dhe përmbajtje të kërkuar;
- b) Punimet të cilat arrijnë pas skadimit të afatit prej 30 ditësh, nga dita e publikimit të konkursit, nuk do të shqyrtohen;
- c) Propozimet e pakompletuara sipas konstatimit të komisionit nuk do të shqyrtohen.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

